

**ON TWO LITTLE-KNOWN ARTICLES OF THE AUTHOR
BRANKO MERXHANIT**

**MBI DY SHKRIME PAK TË NJOHURA TË AUTORIT BRANKO
MERXHANIT**

Loreta LOLI¹

¹**Department of Literature, Faculty of History and Philology, University of Tirana*

²**Corresponding author-mail: loreta.loli@gmail.com*

Abstract

“A country without a library is like a man without his mind: he doesn't know what he's doing, he doesn't know where he's going!”- With these words concludes Branko Merxhani his article on the National Library of Albania on the first day of the new year 1928. For real intellectuals of a country, those who are able to see the light at the end of the tunnel, those who know how to lead the society, who influence and give help in the development of their nation's destinies, the role that educational and cultural institutions have is enormous, irreplaceable. Libraries, as a type of these institutions, and further, the National Libraries, as a separate specificity, take primary importance for the function they have. Especially for that cases when the discourse is contextualized in the creation of new states (but only states and not nations), as was Albania in 1912. Here, the National Libraries become missionaries of archiving the memory and national identity. Albania and the National Library of Albania, as an example of this, became the object of interest, social debate, analysis and concrete and systemic action for some Albanian intellectuals during the 20s and 30s of the last century. In this paperwork, we will focus on Branko Merxhani's view on the role that should have the National Library of Albania as the main national cultural institution. Also we will see the change that this Library has made in our time, from the Traditional Library to the Digital Library, as a necessity to adapt the requests of information society and new technologies.

Keywords: *National Library of Albania, Branko Merxhani, traditional library, digital library, information etc.*

Abstrakt

“Një vënd pa bibliotekë është si një njeri pa mendje: as di ç'bën, as di ku vete! ...”- kështu e përfundonte shkrimin e tij mbi Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë Branko Merxhani në ditën e parë të vitit të ri 1928. Për intelektualët e vërtetë të një vendi, ata që kanë aftësinë për të parë dritë në fund të tunelit, që dinë se si ta drejtojnë një shoqëri, që ndikojnë dhe ndihmojnë aktivisht për zhvillimin e kombit të tyre, roli që kanë institucionet kulturore dhe arsimore është jashtëzakonisht i madh, i pazëvendësueshëm. Bibliotekat, si një lloj i këtyre institucioneve, dhe për më tepër Bibliotekat Kombëtare, si një specifikë më vete, marrin një rëndësi të posaçme për funksionin që kanë. Veçanërisht në ato raste kur diskutimi kontekstualizohet në krijimin e shteteve të reja (por vetëm të shteteve dhe jo kombeve), sikundër ishte Shqipëria më 1912. Këtu, Bibliotekat Kombëtare kthehen në misionare të arkivimit, ruajtjes së kujtesës dhe identitetit kombëtar. Shqipëria dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, si një shembull i kësaj, u kthye në objekt interesi dhe u përfshi në debate sociale, analiza dhe veprime konkrete për disa intelektualë shqiptarë gjatë viteve '20-të, '30-të të shekullit të kaluar. Në punimin tonë do të merremi me qasjen që pati Branko Merxhani mbi

rolin që duhet të kishte Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë si institucioni kryesor kulturor kombëtar. Po ashtu do të merremi me ndryshimin që ka pësuar filozofia e Bibliotekës Kombëtare nga një bibliotekë tradicionale drejt një biblioteke digjitale, si një hap i domosdoshëm që kërkon sot shoqëria e informacionit dhe e teknologjive të reja.

Fjalët kyçe: Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Branko Merxhani, biblioteka tradicionale, biblioteka digjitale, informacion etj.

“Mbi Bibliothekë e Muzé” dhe “Mbi Bibliothekë” janë dy shkrime pak të njohura¹ për lexuesin e specializuar, ndërsa për lexuesin e gjerë, ndoshta, edhe të panjohura, që kanë për autor Branko Merxhanin. Në dy botimet e rëndësishme që i janë bërë veprës së B. Merxhanit, i pari më 1996, me titullin “Formula të Neo-Shqiptarizmës”², përgatitur nga Aurel Plasari, dhe i dyti më 2003, me titullin “Vepra”³, botim më gjithëpërfshirës, përgatitur nga Aurel Plasari dhe Ndrizim Kulla, shkrimet e cituara mungojnë.

Ato u botuan në të mirënjohurën gazetë shqiptare që veproi në vend gjatë viteve 1925-1939, - te “Demokratia”, që dilte në Gjirokastrë, një gazetë e kthyer asokohe në tribunë të fjalës e mendimit emancipues, përparimtar e modern, plot vitalitet, e njohur, referuar dhe çmuar edhe nga gazeta të huaja.⁴ Kjo, falë bashkëpunësorëve të spikatur që e ngritën dhe e zhvilluan dukshëm duke e shndërruar në një kopsht të vogël të kulturës shqiptare, ku lulëzoi lëvizja mendore në fushë të publicistikës, sociologjisë, psikologjisë, filozofisë, përkthimit, kritikës mbi përkthimin, arsimit, edukatës, letërsisë, historisë, fesë e qytetërimit etj. Përmendim Jorgji Meksin, i vlerësuar ndryshe edhe si “dekani i gazetarisë shqiptare”, Branko Merxhanin, Vangjel Koçën, Nebil Çikën, Xhevat Kallajxhinë (në fillim drejtor e përgjegjës, më pas edhe pronar i gazetës) etj.

Trioja Merxhani, Koça dhe Çika do ta zhvillojnë karrierën e tyre profesionale dhe do ta shquajnë profilin e intelektualit me frymë perëndimore më fuqishëm në vitet që pasuan, duke u bërë vetë botues të organeve të rëndësishme dhe frymëzuese të shtypit shqiptar në vitet ’30-të, sikundër qenë revistat “Përpyekja Shqiptare”, “Neo-Shqiptarizma”, “Minerva” etj., apo bashkëpunësorë në gazeta e revista simotra prestigjioze, si: “Illyria”, “Bota e Re”, “Koha e Re” etj.

Te “Demokratia” ata shkruan rregullisht në faqet e brendshme të gazetës, veçanërisht në faqen nr.3, e cila u konceptua qysh në fillim që të merrej jo me politikë, por vetëm me probleme të kulturës shqiptare që nuk qenë as të vogla, as të pakta në numër. Kjo faqe iu dedikua kulturës dhe mendimit shqiptar duke i parë të lidhura me kontekstin europian, në komunikim të pandërprerë dhe të kushtëzuar me të. Titulli kryesor që mbajti në ballinë ishte LËVIZJE MENDORE dhe poshtë tij, futur mes thonjzave, shënohej credoja kuptimplote e huazuar nga Gëte: “Jemi dishepuj të një brezi që mundohet të dalë nga errësira në dritë.”

Qëndrimi pro kulturës dhe pro shkencës, duke mos përzier dhe mbajtur larg punët e politikës së kohës nga ajo që autorët e quanin IDEALIN E RI, të artikuluar ndryshe në frymën e NEO-SHQIPTARISMËS, nuk ndryshoi gjatë viteve. Edhe në deklaratën⁵ e botuar në 1931, në nr.290 të gazetës, ata shprehen: “Kjo faqe kulturele e ‘Demokratisë’ redaktohet nga një grup i veçantë, i cili nuk ka as nonjë lidhje me ‘Politikë’. Punërat t’ona të tepërta kulturele nuk na permetojnë që të trazohemi edhe në ‘Politikë’. Politika nuk mund të na tërheqij kurrë gjer sa nuk do të fitojë një ESENCE POZITIVE dhe një IDE TË SINQERTË, gjëra këto që mund të gjenden vetëm në një lëvizje mendore apolitike, ashtu siç përpiqemi të shvillojmë ne këtu.”

¹ Shkrimet do t’i sjellim të plota në fund të punimit

² Merxhani, Branko. *Formula të Neo-Shqiptarizmës*, përgatitur nga Aurel Plasari, “Apollonia”, Tiranë 1996.

³ Merxhani, Branko. *Vepra*, përgatitur nga Aurel Plasari dhe Ndrizim Kulla, “Plejad”, Tiranë 2003.

⁴ “*Demokratia në shtypin e huaj*”, në: “Demokratia”, nr. 194, 9 shkurt 1929, fq.3

⁵ “Deklaratë”, Në: “Demokratia”, nr. 290, 18 korrik 1931, fq.3

Dy shkrimet e Branko Merxhanit mbi bibliotekën u botuan në dy numra të njëpasnjëshëm të “Demokrishtisë”, konkretisht në nr.135 dhe 136. Ato janë shkrimet e para të autorit në këtë gazetë dhe gjithashtu ndër të parat në tërë krijimtarinë e tij në periodikun shqiptar. Ndonëse nga krahasimi formal i titujve hasim në ndryshime: “Mbi Bibliotekë e Muzé” njëri, “Mbi Bibliotekë” tjetri, praktikisht ata janë vazhdim i shoqi-shoqit (edhe redaksia në fund të shkrimit të parë vendos fjalën “vazhdon” dhe paraprin të dytin me sqarimin “Vijon nga numëri 135”). Çka bie shpejt në sy janë datat kur u shkruan artikujt: i pari në 20 dhjetor 1927, në Sopik (fshat në krahinë e Pogonit në Gjirokastër), dhe mbyll numrin e fundit të gazetës për vitin 1927⁶, ndërsa i dyti mban datën 1 janar 1928⁷, sërish në Sopik, duke përfunduar numrin e parë të gazetës për vitin e ri që sapo kish hyrë. Datat kalendarike të një shkrimi mund të jenë dhe rastësore, ndaj mund të mos kthehen në fakte interpretimi, por kjo nuk vlen për rastin tonë. Duke mbajtur parasysh figurën e Branko Merxhanit, i cili është një personalitet përcaktues në formimin dhe zhvillimin e botëkuptimit modern shqiptar gjatë viteve ’30-të si dhe kontributin e tij real fort të çmuar e të rëndësishëm në historinë e shtypit shqiptar, veçanërisht në debatin mbi idetë, një veprimtari që nuk e ndryshoi thelbin e saj përgjatë gjithë kohës që autori jetoi dhe punoi për Shqipërinë (vitet 1925-1939), atëherë, këtu, data kalendarike nuk mbetet thjesht një rastësi por kalon në nivele të tjera interpretimi. Ajo lexohet si një argument më shumë në favor të shqetësimit intelektual dhe përkushtimit atdhetar që rri zgjuar përherë te ky Burrë, i cili, në vigjilie të vitit të ri, pas një viti të mbushur me punë mendore, me plot vështirësi të natyrave nga më të ndryshmet që terreni i ashpër dhe i varfër shqiptar nuk i kursente, aq më pak limeret e gurta dhe të djegura nga dielli atje poshtë në Gjirokastër⁸, fare mirë mund t’i falte mendjes dhe trupit pushim absolut, siç tek e fundit do të ndodhte me shumëkënd në ditën e parë të një viti të ri. Por për Branko Merxhanin duket se pushimi është një “luks” që nuk mund ta mbajë dot, sepse nuk e dëshiron, sepse e refuzon. Lëvizja dhe ndryshimi, - ky është simboli, idoli i tij: “Besoja, besoj e do të vazhdoj të besoj me guxim dhe me entuziazëm, edhe në nevojën edhe në mundësinë e ndryshimit. Është simboli im, idoli im.”⁹

Shqetësimi intelektual që e bluan këtë radhë autorin buron nga fati i Instituteve tona kombëtare, siç i quan ai Bibliotekën edhe Muzenë, sepse në ato vite këto ishin një, të pandara, Bibliotekë dhe Muze bashkë, dhe pason një debat që kishte nisur në shtypin e kohës mbi këtë temë. Merxhani diskuton me lexuesin dhe thërret në skenë për aktivizim intelektualët e rinj shqiptarë mbi interesimin kombëtar që duhet të marrin këto institute, edhe pse me dhimbje pohon vetëm pak rreshta pas nisjes së artikullit se, mjerisht intelektualët mbajnë veç emrin: “...të paktën, djallëria e jon intelektuale të lëkundesh; të tregonte një interesim; të derdhte në shesh ato që di e mendon mbi atë punë. Mjerisht! Intelektualët!... ja një fjalë që përdorim dëndur, me vënd e pavënd! Po ç’bëjnë, ku janë?...”

Pasi përgëzon iniciativën e ministrit të arsimit të asaj kohe, z. Xhafer Ypi, të cilin e quan një ministër punëtor dhe njeri me të vërtetë mendimtar, që nuk lejoi që çështja e instituteve kombëtare të mbetej në gjumë të gjatë, për t’u rizgjuar, ndoshta, në “agimin e një dite të trishtuar...!”, Merxhani tërheq vëmendjen drejtpërdrejt te krijimi i një Biblioteke të Vërtetë Kombëtare të Shqipërisë dhe tek “roli udhëheqës, ndriçues, organizues” që duhet të marrë ajo, sikundër bëjnë bibliotekat e tjera të rajonit, edhe më gjerë. Nuk do të ndalemi këtu në shqetësimin që ngre autori mbi detajet e “ndryshimit të statusit” të godinës që ishte menduar dhe që shpallur

⁶ Data e botimit të gazetës është 31 dhjetor 1927

⁷ Data e botimit të gazetës është 21 janar 1928

⁸ Merxhani, Branko. *Vepra*, përgatitur nga Aurel Plasari dhe Ndriçim Kulla, vep. e cit. fq.263

⁹ *Po aty*

për t'u ngritur si Bibliotekë Kombëtare, edhe me ato pak fonde të mbledhura nga buxheti i varfër i shtetit shqiptar dhe se si kjo godinë "fluturoi papritur në ajër" me një të rënë të lapsit, as me rrugët alternative të propozuara nga vetë ai për mundësitë e zgjidhjes për një ndërtesë të denjë për Bibliotekën tonë, por në konceptin e qartë dhe në informacionin shumë profesional që ka B. Merxhani për mënyrën se si duhet të operojë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Janë për t'u admiruar vizioni, njohuritë bashkëkohore dhe sinkronia shkencore që ka për bibliotekonominë, thënë ndryshe shkencë që merret me funksionimin e bibliotekave, njohja e gjendjes në të cilën ndodhen bibliotekat kombëtare të vendeve të tjera, mënyra si operojnë ato etj. Për shembull, ai jep një pasqyrë të detajuar, të shoqëruar me të dhëna shifrore të të gjithë fondit të koleksioneve bibliotekare që ndodhen në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë, sipas fondit të antikuarit, të dorëshkrimeve, hartave, librave, numrin e botimeve të reja në vite të caktuara, numrin e frekuentimeve nga lexuesit, flet mbi konferencat e përvitshme profesionale në fushën e bibliotekomisë që mbahen nga biblioteka të ndryshme kombëtare, për takimet profesionale që zhvillojnë specialistët e bibliotekave, të cilat i vlerëson dhe i quan të nevojshme që të bëhen periodikisht etj. Dilema që nuk e lë të qetë Branko Merxhanin është roli që duhet të marrë tashmë edhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë të cilën e sheh si "rregulluesen e vërtetë të jetës s'onë mendore".¹⁰

"Cila është ajo institutë q'i jep një drejtim serioz jetës mendore të një vendi; q'i jep asaj një dritë qytetërimi, që shtyn popullin të mendojë e të këndojë, q'u hap udhën e punimit mendimtarëve të tij? Ajo është, pa dyshim, një Bibliothekë kombtare."

Godinën e bibliotekës që vepronte në atë kohë si pjesë e Ministrisë së Arsimit, në kuptimin e infrastrukturës (ndodhej në katin e poshtëm të saj), e sheh si një depo librash të vendosur pa rregull dhe në mënyrë jo sistematike, çfarë e bën të papërshtatshme për të kryer rolin e një Biblioteke Kombëtare. Madje, në këtë formë dhe me këtë përmbajtje (ka shumë libra të panevojshëm/të pavlerë për një Bibliotekë Kombëtare) ajo "nuk mund të përbëjë as themelin e një biblioteke ordinare"¹¹. Bibliotekat e kohërave moderne kërkojnë një "mjeshtëri të hollë, delikate", ndërsa ngritja e tyre kërkon "specialitet, shkencë"- vazhdon arsyetimin Merxhani, dhe pas këtyre fjalëve që pasqyrojnë gjendjen e prapambetur të bibliotekës sonë lexohet dëshpërimi autorial, por edhe Detyra që duhet të përmbushet sa më shpejt nga "dirigjuesit e punëve shtetërore" për sa e çfarë mungon në jetën mendore shqiptare.

Këto kërkesa, që me të drejtë përbëjnë thelbin e një biblioteke si një organizëm shkencor, sepse bibliotekat, dhe posaçërisht ato kombëtare, janë institute që ngrihen mbi themele të diturisë, të perfeksionuara me një mënyrë sistematike, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do të niste t'i përmbushte gjatë veprimtarisë në vitet e Mbretërisë Shqiptare (1928-1939), kur në drejtim vjen Sotir Kolea. Bashkë me drejtuesit e tjerë që e vijuan punën cilësore të nisur nga ai institucioni i Bibliotekës Kombëtare eci i sigurtë përpara.

Sotir Kolea është i njohur për veprimtarinë e tij atdhetare, shumë aktive, pasionante, ashtu siç qe i tërë brezi i patriotëve shqiptarë që ecën në gjurmët e Rilindjes Kombëtare, por në detyrën e tij si Drejtor i Bibliotekës Kombëtare (1928-1937), ai zë një vend të veçantë sepse futi dhe zbatoi për herë të parë kriteret e shkencës së bibliotekomisë. Fondi i koleksioneve filloi të inventarizohej, të katalogizohej sistematikisht, filluan të botoheshin vjetarë mbi frekuentimet dhe pasurimet (dhurimet/shtimet) që bëheshin çdo vit në fondin e bibliotekës etj. Nga fondi prej 6,000¹² vëllimesh që kishte BKSH në momentin e përrurimit të saj në vitin 1922, në mbarimin e

¹⁰ "Demokratia", 21 janar 1928

¹¹ "Demokratia", 21 janar 1928

¹² Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e BKSH-së: www.bksh.al

Luftës së Dytë Botërore koleksioni do të shkonte në 15.000, ndërsa në fund të vitit 1947 rreth 100.000 të tilla. Është e kuptueshme se pa një organizim specifik shkencor sipas parimeve të bibliotekonomisë dhe punës së përkushtuar të brezave që e udhëhoqën dhe kontribuan për këtë institucion kjo pasuri e paçmuar kombëtare nuk mund të mbijetonte dhe të transmetohej në breza. Për më tepër që fondet e BKSH-së nuk përmbanin vetëm trashëgiminë e shkruar të shekullit XX, përkundrazi, moshë e koleksioneve ishte shumë më e hershme se moshë e godinës që i strehoi dhe vazhdon t'i strehojë ato. Falë dhuratave që bënë patriotë të ndryshëm shqiptarë, deri në dorëzime të bibliotekave të tyre personale, albanologë të shquar e shumë e shumë personalitete të tjera të nderuara, apo në sajë të konfiskimeve që u bëri regjimi komunist librarive dhe bibliotekave private të disa prej intelektualëve shqiptarë, në fondin e BKSH-së u strehuan thesare të kulturës kombëtare dhe asaj botërore, si p.sh. inkunambula të shekullit XV, dorëshkrime arabo-turke edhe më të vjetra se ky shekull, kodikë, antikuarë të ndryshëm të shtypur në shtypshkronjat më prestigjioze të Europës dhe më gjerë, ku shkëlqejnë ato të periudhës bizantine e postbizantine etj.

Pjesa thelbësore e identitetit tonë kombëtar, por edhe atij europian gjendet në fondet e kësaj biblioteke, duke dëshmuar për një komunikim të pandërprerë historik e kulturor. Rrinë bashkë vepra më e vjetër që daton në fondin antikuar të BKSH-së, “Epistolae de Conventu Mantovano” (1473) e Papa Piu-t II dhe botimet e rralla të 1500 –ës të autorëve greko-romakë, veprat e humanistëve shqiptarë dhe koleksioni i jashtëzakonshëm i Corpus Historiae Byzantinae¹³, abetaret e para në gjuhën shqipe të shkruara me alfabetet që përdorshin në fundshekullin XIX e fillimin e XX me kopjet unikalë të 6 vëllimeve në dorëshkrim në gjermanisht të konsullit austriak Franz Nopcsa etj., etj. Në këto fonde janë strehuar thesaret e mendjeve të ndritura të kombit tonë dhe personaliteteve të huaja, siç është biblioteka e Bushatllinjve, biblioteka personale e Faik Konicës, e Mit’hat Frashërit, biblioteka e Mitrush Kutelit, biblioteka e profesor Gustav Weigand-it, e profesor Aleks Budës, profesor Karl Gurakuqit e shumë të tjera, fakte që secilin prej nesh e bëjnë të ndihet krenar dhe të ushqejë vetëm respekt, respekt të thellë të sinqertë për punën e çmuar ndër vite.

Nëse gjatë periudhës së regjimit komunist veproi modeli i bibliotekave të Europës Lindore, me kufizime ekstreme në sigurimin e informacionit dhe shfrytëzimin e disa kategorive të literaturës, sistemi demokratik i viteve ’90-të solli ndryshime edhe në filozofinë e Bibliotekës Kombëtare. Ajo hoqi barrierat kufizuese të kësaj natyre, duke shkuar drejt lirisë së plotë të informacionit për përdoruesit.

Sot, kur *de jure* kemi festuar 100-vjetorin e themelimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (2020) dhe kur koha dhe kushtet teknologjike imponojnë një tjetër mënyrë ndërveprimi me informacionin dhe koleksionet bibliotekare, në BKSH ka marrë prioritet aktivizimi i bibliotekës digjitale e cila i mundëson lexuesit qasje në mënyrë virtuale në koleksionet e ndryshme, një mënyrë kjo që po dominon komunikimin lexues/bibliotekë në të gjitha bibliotekat kombëtare të botës. Biblioteka digjitale përbën sfidën e kohës, më të madhen për Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në shekullin XXI. Ky është shekulli i lexuesit postmodern, që ka dhe kërkon ritme të reja, të shpejta komunikimi ndaj dhe biblioteka duhet të shkojë në një hap me të.

95 vite më parë Branko Merxhani e përmbyllte shkrimin mbi bibliotekën me sentencën: “Një vënd pa bibliotekë është si një njeri pa mendje: as di ç’bën, as di ku vete!”, ndërsa sot, kur Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë e ka përmbushur këtë mision, është rritur e zhvilluar përkrah simotrave në rajon e më tej, dëshira është që **Ajo** të bëhet vendi ku njerëzit e shekullit XXI të

¹³ Misha, Piro. *Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*, Mediaprint, Tiranë, 2020, fq. 7

kenë mundësinë t'i qasen pasurisë shpirtërore kombëtare me lehtësinë që jep teknologjia, që të ndriçohen e zhvillohen në rrugëtimin e tyre.
Institutet t'ona kombtare¹⁴

Mbi Bibliotekë e Muzé

Këto kohët e fundit, shtypi ynë ka nisur të bëjë fjalë mbi nevojën e një biblioteke e të një muezeje. Për të pohuar të vërtetën duhet të shënojmë se një thellim më i thellë dhe një diskutim më serioz mbi këtë çështje, që përbën themelet e jetës s'onë intelektuale, lybnin me të vërtetë një mundim, i cili do të përfundonte në një shërbim. Dëshëronim që, kur bëhet fjalë për bibliotekë ose muze, të paktën, djalëria e jonë intelektuale të lëkundesh; të tregonte një interesim; të derdhte në shesh ato që di e mendon mbi atë punë. Mjerisht! Intelektualë! ... Ja një fjalë q'e përdorim dëndur, me vënd e pa vënd! Po ç'bëjnë, ku janë? ... Sikurse për çdo punë, edhe për këtë, u-shfaqnë disa mendime me përpjekjen dhe interesimin e një Ministri punëtor, njeri me të vërtetë mendimtar: mos të kishte zënë postin e Arësimit Xhafer Ypi, sikurse, mijra nevoja e të meta të jetës s'onë mendore, edhe kjo çështje do të mbetesh e dënuar në një gjumë për t'u rizgjuar, ndofta, n'agimin e një dite të trishtuar! ... Dhe nga ky shkak, n'emër të jetës s'onë kulturore, sa e varfër aq e neglizhuar dhe e përbuzur, e quajmë një detyrë kryesore t'i shfaqim këtu Ministrin vullnet-madh ndjenjat t'ona mirënjohëse. Sepse s'ka dyshim që krijimin e shvillimin e këtyre institutëve tona kombtare që ndodhen edhe në diep, do t'ua detyrojmë mëndjes së ndritur, vullnetit të fortë dhe inteligjencës së shkëlqyer t'atij Ministri të mbaruar e plot virtyte.

* *
*

Kur kujtojmë bibliotekën e muzen t'onë, na vjen ndërmend jeta fatale e vjetëvet të parë të krijimit të kësaj Institute të vogël; na vjen keq e çuditimi sa gjë e dobët e pa kuptim konsiderohet, mierisht, në vendin t'onë, virtyta kombëtare. Dy tre vjet të shkuara, kishim një godinë të vogël, e destinuar për Bibliotekë e Muze. Në vendin e asaj godine, e ngrehur me fondet e pakta të Buxhetit t'onë të varfër, tani s'ka mbetur gjurmë. Përse, ç'u bë? A mos ra vetëtima dhe e shduku, apo një shtërgatë e fluturoi? Po, mbi atë vënd fatzi, shkoi një furtunë, e tërbuar dhe e zezë; furtuna e padies, armikja e virtytës! ...

Në vënde të tjera, të pasurit konkurojnë midis tyre: kush të ngrehë një shkollë; kush të krijojë një bibliotekë ose t'i falë popullit një anije. Ç'bëjnë vallë të pasurit t'onë? Presim dhe kemi plotësisht të drejtë të presim, edhe nga këta që të bëjnë dishka; besojmë se erdhi koha dhe shkoi për 'ta që të tregojnë nga një vepër fisnike, të kujtuëshme, të vjefshme ndaj kulturës s'onë të ngratë. Me këto fjalë, mos kujto, i shtrënjti këndonjës, se nuk është dhënë asnjë shëmbëll prej bashkë-qytetarëve t'anë: e quajmë prapë për një detyrë të përmendim në këto radhë, me ndjenja respekti e mirënjohje, Ali Agjah Bej Elbasanin, i cili i ka dhuruar me anë të një testamenti një pjesë të pasuris së tij Arësimit Kombëtar dhe zotni Turtullin, i cili është tue ngrehur në Korçë një bibliotekë popullore.

(Vashdon)

BRANKO MERXHANI

(Sopik, më 20 Dhjetor 1927)

Institutet t'ona kombtare¹⁵

¹⁴ "Demokratia", nr. 135, 31 dhjetor 1927

Mbi Bibliothekë

(Vijon nga numëri 135)

Ta kufizojmë themën: Bibliotheka kombtare do të jetë rregulluesja e vërtetë e jetës s'onë mendore. Nga kjo pikë-pamje, ata që mendojnë se, sot për sot, kemi një farë biblioteke, qoft' edhe si një depo librash, gabohen tepër. Në katin e poshtëmë të Ministris' s'Arësimit, janë vendosur pa rregull disa mijë libra - shumica e të cilavet pa vleftë dhe të papërshtatëshme për një bibliotekë systematike – që s'mundin të përbëjnë as themelin e një biblioteke ordinare e jo kombtare. Në duam ta kemi një bibliotekë të vërtetë, duhet t'a nisim punën nga e para.

Në kohën e sotëme, ngrehja e një biblioteke është një specialitet, një shkencë, mund të themi edhe se është një mjeshtëri e hollë, delikate. Në disa universitet t'Evropës janë krijuar frone të posaçëme për këtë degë. Një drejtor i cili e lidh mëndjen në një bibliotekë, ose një dijetar që merret me librat e veta, nuk gjen kohë për t-u marrë edhe me një pjesë tjetër të dituris. Prandaj kjo mjeshtëri, për shvillimin e saj, ka nevojë për një punim të gjerë, të rëndë e të vrejtshtëm. Gjithë kjo arësye, drejtorët e bibliotekarët e Perëndimit, herë pas here, bëjnë kongrese nëpër kryeqytete të ndryshme; shtrojnë në diskutim ato që dinë dhe ato që kanë fituar nga eksperiencia e tyre; dhe në këtë mënyrë, përpiqen të zhvillojnë, të perfeksionojnë specialitetin e tyre.

Cila është ajo institutë q'i jep një drejtim serioz jetës mendore të një vendi; q'i jep asaj një dritë qytetërimi; që shtyn popullin të mendojë e të këndojë, q'u hap udhën e punimit mendimtarëvet të tij? Ajo është, pa dyshim, një Bibliothekë kombtare, e ngrehur mbi themele të dituris, e perfeksionuar me një mënyrë systematike. Ditën kur ne do të ngrehim një institutë t'atillë, do të kemi fatin e mirë, të shohim një fole të këndëshme, një vepër frytëdhënëse për jetën t'onë mendore, një vatrë të vërtetë të dituris.

* *
*

Për të kuptuar barën dhe rëndësin e punës që do të kemi kryer me ngrehjen e një biblioteke, s'ka nevojë të vemi larg. Duam të përmendim edhe se këto që shkruajmë sot nuk janë një studim teknik, por vetëm si një artikull i vogël fletoreje. Qëllimi i vetëm që ndiekim me këto radhë është që të ngjallim pak në djalërin t'onë këtë çështje e cila meriton me të vërtetë një vërejtje, një kujdes të posaçëm. Kështu, të krijojmë një aktivitet, një lëvizje serioze reth të tilla çështjeve mendore e shoqërore që kanë të bëjnë direktëment me t'arthmen e vëndit t'onë: një lëvizje mendore ...

Po, sikurse thamë, nuk duhet të vemi larg: mjafton t'i hedhim një vështrim po thuaj fqinjës, motrës s'onë ballkanike, Bullgaris. Ky vënd, i cili s'ka të shkuar diturie e një jetë independence tepër të gjatë, ka një jetë mendore mjaft të gjallë e të pasur, një kulturë e letërsi kombtare mjaft të zhvilluar, të cilat ia detyron, për pjesën më të madhe, punimit shkencor, rregullimit të bukur Bibliothekës së vetë kombtare e të pasur. Pas një statistike të botuar prej Bibliothekës kombtare të Sofjes, në vitin 1923, në Bullgari, pa u-marë parasysht rivistat, javore ose mujore, janë shtypur 3639 libra. Gjithë n'atë vit, Bullgarët kanë patur 482 fletore dhe 235 rivista. Si të lëmë më nj'anë fletoret politike, ekonomike dhe zyrtare, vetëm në Sofje botohen 171 rivista, nga të cilat 54 letrare, 34 edukative, etj.*).¹⁶

Kjo institutë diturie, q'është ngrehur në vitin 1878 me inisiativën e shtytjen e general Atabinut, Komandanti i Armatës okupuese ruse, sot, ka pesë dega të mëdha e të pasura:

1. - Dorëshkrimet e shtypet e vjetëra;

¹⁵ "Demokratia", nr. 136, 21 janar 1928

¹⁶ *) Godisnik na varodnata Biblioteka Sofia Za g. 1923, (Sofia Drzhith pecatnika 1928, 281 p. 100 Leva).

- II. - Veprat bullgaristike mbi jetën dhe historin e popujvet ballkanikë;
- III. - Dega orientalistike;
- IV. - Dega e arshivavet;
- V. - Dega e përgjithëshme.

Bibliotheka, duke qenë nënë direksionin e D. Angelovit, një mendimtar e kritikant bullgar, administrohet prej një trupi dijetarësh i përbërë prej pesë vetash. Tre nga këta janë Bibliothekarë, dhe të tjerët janë V. N. Ziataraki, një nga profesorët me vleftë t'universitetit të Sofjës, dhe B. Conevi, një nga slavistët bullgarë i dëgjuar. Gjëndja e sotëme e bibliotekës, e cila dyzet' e nëntë vjet më parë s'ka qenë veçse një zyrë e vogël, është kjo: 126617 volume në bullgarisht e në gjuhët e tjera t'Europës; 21957 volume në 2 copë; 26,347 volume koleksione fletorësh e rivistash, 4520 volume libra në gjuhët e ndryshme t'Orientit, dorëshkrime e dokumenta; 1090 volume shkrime të vjetëra sllavistike, që totalisht bëjnë 179536! Vetëm në vitin 1923, 16323 kënduan 12431 libra.

Besojmë se, me shpiegimet e shkurta të sipërme e me shifrat që përmendëm, dhamë një mendim të kthiellët mbi jetën kulturore të Bullgaris. Por pika mbi të cilën duam të tërheqim vrejtnjen e shokëvet t'onë intelektualë dhe veçanërisht të dirigjuesvet të punëvet shtetërore, është roli që lot një bibliotekë nga pikë-pamja e drejtimit e të zhvillimit të jetës mendore të një kombi. Një vënd pa bibliotekë është si një njeri pa mëndje: as di ç'bën, as di ku vete! ...

BRANKO MERXHANI

Sopik, 1-1-1928

Referencat

- [1]. Merxhani, Branko. *Formula të Neo-Shqiptarizms, përgatitur nga Aurel Plasari*, "Apollonia", Tiranë, 1996.
- [2]. Merxhani, Branko. *Vepra, përgatitur nga Aurel Plasari dhe Ndriçim Kulla*, "Plejad", Tiranë, 2003.
- [3]. Misha, Piro. *Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*, Mediaprint, Tiranë, 2020.
- [4]. Gazeta "Demokratia", nr. 135, 31 dhjetor 1927.
- [5]. Gazeta "Demokratia", nr. 136, 21 janar 1928.
- [6]. Gazeta "Demokratia", nr. 194, 9 shkurt 1929.
- [7]. Gazeta "Demokratia", nr. 290, 18 korrik 1931.